




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Nr. 155215/18 Prot



Tiranë, më 27/07/2023

**Lënda** : Dërgohet – Shpallje Ankandit të Tretë Për Shitje Sendi Të Paluajtshëm

**Drejtuar** : Njesia Administrative Vreshtas, Korce

Bashkëngjitur kësaj shkrese Ju dërgojmë dokumentin me Nr. 155215/16 Prot, Datë 27/07/2023 për shpalljen e ankandit të tretë për shitjen e sendit të paluajtshëm, i përpiluar nga Përmbaruesi Gjyqësor Privat.

Duke qenë në dijeni se pranë çdo Bashkie funksionon Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, apo Sektori i Informimit Qytetar, si edhe masat dhe përgatitjen që bën ky sektor për bërjen publike të informacioneve të ndryshme që vihen në dispozicion të publikut, pa kërkesë.

Ju dërgojmë këtë shpallje për t'a afishuar në ambientet e përcaktuara të Bashkisë, të cilat janë të disponueshme dhe shërbejnë për të njëjtat qëllime informuese.


Referuar nenit 568 të K.Pr.Civile, kërkojmë nga ana Juaj që të krijohen kushtet e duhura për publikimin dhe mbarëvajtjen e kësaj shpalljeje për një periudhë 30 - ditore.

Ju Faleminderit për bashkëpunimin!

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.

PËRMBARUES GJYQËSOR

Rigels BEJKO



Nj. A. Vreshtas  
STIMP ✓  
dt 11.08.2023

Nr. 111 Prot  
dt. 14.08.2023



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE**

Nr. 155215/16 Prot

Tiranë, më 27/07/2023

**SHPALLJE**

**(PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKANDIN III)**

Unë, Rigels Bejko, me detyrën Përmbarues Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.41-2011-757(135 prot)Vendim, datë 23/02/2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore, kërkesën e kreditorit Institucioni financiar Micro Credit Albania shpk, zgjedhur te perfaqesohet ne rruge gjyqesore dhe/ose jashtegjyqesisht nga subjekti juridik ADCA shpk me NIUS K92012006Q, ndaj debitorit, në lidhje me titullin ekzekutiv “Kontrate Kredie Nr.F-8333 dt 19.03.2008 dhe Kontrate Kredie Nr.51002381, date 14/02/2009”.

Me përmbushjen konform ligjit të të gjithë hapave të parashikuara dhe të kërkuara procedurale, si edhe me përfundimin e afatit të fundit të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm parashikuar në nenin 577 të Kodit të Procedurës Civile, më datë 26/06/2023 kreu shpalljen e ankandit të dytë për shitjen e sendit të paluajshëm të sekuestruar. Procedura e zhvillimit të ankandit vazhdoi 30-ditë dhe përfundoi me mbarimin e orarit zyrtar të datës 27/07/2023.

Nga procedura e zhvillimit të ankandit si edhe nga proces-verbali i datës 27/07/2023 të zhvillimit të tij,

**KONSTATOVA**

Se në të gjithë afatin 30-ditor të mbajtjes së afishimit të shitjes së sendit të paluajshëm, ashtu si edhe në ditën përfundimtare të zhvillimit të tij, nuk u paraqit asnjë ofertë apo ofertues, i cili do të paraqitej si blerës i mundshëm i këtij objekti të përcaktuar me një çmim fillestar në vlerën e **67,760 (Gjashtedhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtedhjetë) LEKË**

Lidhur sa më sipër, referuar neneve 568 dhe 570 dhe 577 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe Ligjit Nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat” bëj këtë:

**SHPALLJE**

1. Për shitjen ne ankand të sendit të paluajshëm, si më poshtë treguar:  
**Pasuria 1:** Are, Nr.Pasurie 148/210, Zona Kadastrale 3010, Vol.16, Faqe 130, me sipërfaqe 1039 m2, ndodhur ne Podgorie, Korce.
2. E cila është në pronësi të Viktor Enver Rozani, dtl 01.06.1960

Me këtë shpallje njoftoj të gjithë të interesuarit, duke i

**INFORMUAR SE**

- a) Çmimi i sendit të paluajshëm që shitet ka vlerën si më poshtë treguar:  
**Pasuria 1:** Are, Nr.Pasurie 148/210, Zona Kadastrale 3010, Vol.16, Faqe 130, me sipërfaqe 1039 m2, ndodhur ne Podgorie, Korce.  
> Në vlerën **12,100 (Dymbëdhjetë mijë e njëqind) LEKË**.
- b) Vendi ku do të zhvillohet ankandi i shitjes së sendit është salla e mbledhjeve të Zyrës së Përmbarimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k. e cila gjendet në adresën: **BULEVARDI “GJERGJ FISHTA” KULLA NR. 5, KATI 11-TË, NR.54 TIRANË**
- c) Ankandi III për shitjen e sendit të paluajshëm shpallet sot dhe do të qëndrojë i publikuar deri më datë 28/08/2023.
- d) Dorëzimi i kërkesave për pjesëmarrjen në ankand do të pranohen në të gjithë afatin 30 - ditor dhe procesi përfundimtar i zhvillimit të ankandit do të kryhet në datën **28/08/2023** duke u mbyllur në orën 16.00 me mbarimin e orarit zyrtar.
- e) Secili ofertues duhet të depozitojë bashke me kërkesën për pjesëmarrjen në ankand edhe garancinë prej 10% të çmimit fillestar në llogarinë e Vecantë bankare.

**KJO SHPALLJE AFISHOHET NË:** Njesia Administrative Vreshtas, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korce, Adresën e sendit të paluajshëm që shitet në Korce, Në dy gazeta kombëtare për 5 ditë me radhë dhe Zyrën e Përmbarimit Privat “TDR GROUP” sh.p.k.

**ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “TDR GROUP” sh.p.k.**

**PËRMBARUES GJYQËSORË**

**Rigels BEJKO**

